

Salajdin SALIHI

LUFTA KUNDËR MONUMENTEVE NË TETOVË GJATË VITEVE 30 TË SHEKULLIT XX

UDC 930.85(497.751)

Abstrakti: Autoritetet serbe gjatë viteve '30 të shekullit XX sajnin shkaqe të ndryshme që t'i rrënonin monumentet kulturore dhe historike në Tetovë. Kundër vendimit për rrënimin e Hamamit të Tetovës dhe Urës së Gurit kishin reaguar jo vetëm qytetarët shqiptarë. Kishte edhe autorë jo shqiptarë që reagues nëpërmjet shtypit të kohës. Në këtë periudhë ishte rrënuar edhe Kulla e Sahatit në Tetovë, e cila nga shumë udhëpërshkrues, por edhe nga banorët e Tetovës, është quajtur "veçanti e qytetit".

Fjalët kyçe: Monumentet, Tetova, Hamami, Ura e Gurit, Kulla e Sahatit

Autoritetet serbe gjatë viteve '30 të shekullit XX shpesh sajnin shkaqe të ndryshme që t'i rrënonin monumentet kulturore dhe historike në Tetovë. Gazetat serbe të kohës kanë shkruar, madje, se për ndërtimin e disa rrugicave periferike ishin shfrytëzuar blloqe të monumenteve historike (siç ishte rasti i Hamamit të Tetovës). Në vitin 1933 u rrënuar Kulla e Sahatit në Tetovë, e cila nga udhëpërshkruesit dhe banorët e Tetovës konsiderohej si njëra nga veçantitë e qytetit.

Kulla e Sahatit, e cila lartësohej në njërin prej pjesëve kryesore të Tetovës, ishte rrënuar me pretekstin se në rast të shembjes mund ta rrezikonte jetën e banorëve.

Sahat Kulla ishte 40 metër e lartë, e ndërtuar me gurë e mermer dhe me maje prej druri. Ajo besohet se ishte financuar nga Mehmet Pashë Kaçaniku në fund të shekullit XVI dhe në fillimshekullin XVII. Funkzioni i saj ishte që ta tregonte kohën e namazit në Mëhallën e Sahatit.

Ministria e Ndërtimit e Mbretërisë Jugosllave, më 1933, kishte marrë vendim edhe për rrënimin e Hamamit të Tetovës dhe Urës së Gurit. Sipas vendimit, që fatmirësisht nuk u zbatua, duhej të rrënoheshin Hamami i Tetovës (që vazhdonte të shërbente ende si banjë publike) dhe Ura e Gurit. Në këtë lokalitet duhej që të ndërtohej një urë e betonit ose e hekurit, e cila, sikurse thuhej, do të mundësonte qarkullim më të madh të mallrave. Serbia e konsideronte Tetovën si një vend tejet strategjik, sepse aty kalonte udha e cila i lidhte disa qytete. Por banorët lokalë, pa dallim përkatësie etnike dhe fetare, kishin reaguar kundër këtij vendimi.

Autori me pseudonimin "Kronisti", në shkrimin "*Serbia Jugore dhe monumentet historike të saj*" (1933)¹, pasi e përshkruan Tetovën si vend joshës për turistët, dëshmon pjesa e vjetër e Tetovës, pra shtëpitë, rrugët dhe rrugicat karakteristike, ishin shkatërruar.

"Tetova është joshëse dhe shumë e vizituar prej turistëve e huaj për shkak të pamjes orientale (xhamive, minareve, konakëve, qytetit të vjetër në Kala, teqeve dhe arkitekturës së vjetër). Prej nga e gjithë kjo dashuri për Tetovën? Kjo dashuri lidhet me veçantitë e rralla që shfaqen me gjithë reflektimin e tyre. Sa është e shprehur dashuria jonë për këtë vend me të cilin na lidhin shumë ngjarje jetësore? Pas luftës është dëmtuar e gjithë pjesa e

¹ Kroniçar, "Јужна Србија и историски старине у њој", Pravda, 25 tetor 1933.

vjetër, pavarësisht nëse ka vlerë historike ose jo. Është shkatërruar gjithçka, sepse është lënë në vullnetin e individëve pa ndonjë kuptim për këto vlera, të cilët, shpesh herë, janë nisur nga qëllimet praktike.

Gjatë viteve të fundit sikur u vlerësuan më shumë vlerat e lashtësisë. Ato ndaluan së rrënuari. Megjithatë, këtë vit, disa trashëgimtarë të pashallarëve, që rijnë në teqenë e dervishëve (të cilët e shitën pronën e tyre të trashëguar), duke mos pasur dru për ngrohje e kanë shkatërruar derën e varoshit të teqesë, çardakët dhe pjesët e drurit (që ishin atraksion për të huajt), që t'i përdornin dyert si dru për ngrohje. Çuditërisht se si askush nuk i kundërvihet kësaj vetëplaçkitje, as Komisioni i Vakëfeve, i cili ka kontest pronësor me trashëgimtarët e kësaj prone. A nuk mundi të ndërhynte edhe komuna e Tetovës?

Autori e kundërshton edhe vendimin për shkatërrimin e Hamamit dhe Urës së Gurit në Tetovë. Sipas tij, nëse do të rrënoheshin Hamami dhe Ura e Gurit, atëherë Tetova nuk do të ishte më atraksion arkitektonik dhe turistik.

"Flitet se së shpejti do të rrënohet edhe Hamami i qytetit (banja publike) dhe Ura e Gurit mbi lumin Shkumbin (në origjinal: Pena), sepse afër saj do të ndërtohet një urë e re prej hekuri, e cila do ta lidh rrugën e re "Karagjorgjeva" me rrugën "Vojvoda Stepe". Ura e Gurit ka vlerë të veçantë dhe shërben mrekullisht për trafik pa e penguar ndërtimin e dy urave përballë njëra - tjetrës. Është e vërtetë se të gjithë ne e dëshirojmë që Tetova, prej një kasabajë të vogël turke, të shndërrohet në varosh modern. Deri diku ja kemi arritur qëllimit (kohët e fundit ka veprimtari të madhe ndërtimore). Por sado mundohemi nuk arrijmë që Tetovës t'ia ndryshojmë imazhin e vjetër patriarkal. Me rrënimin e këtyre monumenteve në Tetovë nuk do të ndryshohet ngjyra patriarkale, sepse rregullimi i pjesës së epërme të varoshit asnjëherë nuk do të bëhet. Me rrënimin e këtyre monumenteve Tetova pushon së qeni atraksion dhe e humb vlerën karakteristike.

Së fundmi, duke çmuar vlerën e monumenteve historike dhe duke pasur parasysh Ligjin e ri për ndërtim, parashikohet ruajtja e ndërtimeve historike dhe kulturore të qyteteve, të ndërtesave tipike e kështu me radhë, kurse në Beograd është krijuar një këshill profesional për mbrojtjen e monumenteve.

Verën e kaluar këtu ishte edhe piktori gjerman z. Helmut Kromeri. Ai pasi u kthye në Berlin çoi atje shumë piktura dhe hapi një ekspozitë me motive nga Serbia Jugore.

Përsëris, Pollogu klasik dhe Tetova e mahnitshme nuk guxojnë të ngelin pa monumentet e tyre, sepse janë pjesë e vlerave të saj. Si shembull mund të na shërbejnë edhe vizitat e të huajve këtu përgjatë këtij viti".

Vendimi për rrënimin e Hamamit dhe Urës së Gurit, u kundërshtua edhe nga Bora Josifoviç, korrespondent nga Tetova i gazetës "Vreme"¹. Ai nuk ishte kundër se në Tetovë kishte ndërtime të reja, por pa u prekur ndërtimet e vjetra. Sipas gazetarit, kjo pasuri historike dhe kulturore mund të nxiste turizmin kulturor. Gazetari i kritikonte autoritetet e Beogradit dhe e përlligjte revoltën e tetovarëve. Ishte kritik edhe ndaj Këshillit për Mbrojtjen e Monumenteve në Beograd, sepse nuk reagoonte kundër vendimit për rrënimin e dy monumenteve historike.

Presioni i qytetarëve, pavarësisht dallimeve fetare e etnike, por edhe i gazetarëve të kohës, kishte ndikuar tek autoritetet serbe që të hiqnin dorë nga ky vendim.

Autoritetet vendore, në këtë periudhë, kishin lejuar dëmtimin e shumë vlerave kulturore dhe historike në Tetovë. Prej monumenteve që pësuan dëmtime serioze janë konakët e njohur të pashallarëve të Tetovës. Kështu, në një shkrim në "Vreme", të vitit 1936, thuhet se konakët e Abdurahman Pashës ishin bërë zyra dhe banesa. Në këtë shkrim, ku botohen edhe dy fotografi nga ky monument historik, thuhet: "Secilit që vjen në Tetovë dhe dëshiron t'i sheh veçantitë, ia tregojmë Xhaminë e Larme, urat shekullore të gurit, Harabati Baba Teqenë dhe konakët e Pashait, zotëruesi i të cilëve deshi ta bënte Kalkandelenin (Tetovën) seli të sulltanatit të ri. Komuna vërtet e bleu njërin konak, që e mendoj si

¹ Bora Josifoviç, "Пред рушењем градско амама, чувеног пашиног моста у Тетово", Vreme, Beograd, 8 tetor 1934, f. 7.

muze, por përderisa bëhej muzeu, njëkohësisht "bëheshin" bisedime dhe diskutime, që ndryshuan situatën dhe sollën deri te dështimi i gjithë planit të komunës së Tetovës dhe Këshillit për mbrojtjen e monumenteve. Komuna ishte e detyruar që të vendosej në konakun e blerë, pra në ndërtesën që ishte e dedikuar për muzeun e Tetovës. Por konaku, ashtu siç e la famëkeqi Abdurahman Pasha para 100 vjetësh, nuk përshtatej për këtë qëllim, prandaj duhej krijimi i hapësirave të reja. Brendia e ndërtesës u ndryshua plotësisht. Nga kopshti u largua çezma prej mermerit të bardhë, si dhe disa pjesë të tjera pranë ndërtesës. Kopshti i luleve u rrafshua. Kopshti i ruajtur me decenie u shndërrua në kopsht të rëndomtë. Këto ditë të njëjtin fat e pati edhe konaku tjetër i Abdurahman Pashës. Atë e bleu avokati z. Sima K. Momiroviqi. Natyrisht edhe z. Momiroviqi, që dha aq shumë para, dëshiroi të kishte sa më shumë dobi nga prona. Ai e rinovoi dhe e ndërtoi atë, duke i dhënë konakut një pamje krejtësisht të re. Selamllëku i dikurshëm me zyrën e Pashait dhe skrivaninë ku hatibët gjysmë analfabetë me këmbët e mbledhura përfund saj shkarravitnin nëpër letra, është rinovuar në tërësi, është suvatosur si nga jashtë, po ashtu edhe brenda. Ka mbetur vetëm haremi i dikurshëm, shumë i përmendur, si dhe kulla e rojës, që dominon në anën e djathtë të varoshit. Por nga ajo është hequr gjithçka që deri para pak kohësh na e kujtonte epokën feudale të "mjerimit turk". Konaku i tretë, me gjithë ndërtesat, iu dha si zyrë Seksionit të kadastrës, kurse në konakun e katërt është vendosur shkolla fillore 'Vuk Karaxhiq'¹.

Fatkeqësisht lufta kundër monumenteve kulturore e historike vazhdoi edhe pas kësaj periudhe, gjegjësisht në kohën e Jugosllavisë së Titos.

¹ "Конаци Абдурахман - паше у Тетову кои је од Калканделена хтео да створи престоницу новог султана, претворени су у канцеларија и станови", Време, Београд, 21 нентор 1936, ф. 5.